

Raporti organik
i vendit

2022



KOSOVË

Raport mbi Statusin e
Bujqësisë Organike dhe
Industrië në Kosovë

Gefördert durch



Bundesministerium
für Ernährung
und Landwirtschaft

BÖLN

Bundesprogramm Ökologischer Landbau
und andere Formen nachhaltiger
Landwirtschaft

aufgrund eines Beschlusses des
Deutschen Bundestages

Imprint

Redaktor

Joachim Lenz,
Claudia Neumannn



EkoConnect e.V.
Schützengasse 16
01067 Dresden
www.ekoconnect.org

Autor

Iliriana Miftari

Lektorimi

EkoConnect e.V.

Paraqitja & Shtypshkronja

www.whateverworks.biz

Gefördert durch



Bundesministerium
für Ernährung
und Landwirtschaft

BÖLN

Bundesprogramm Ökologischer Landbau
und andere Formen nachhaltiger
Landwirtschaft

aufgrund eines Beschlusses des
Deutschen Bundestages

Mohim përgjegjësie

Ky raport është financuar nga Ministria e Ushqimit dhe Bujqësisë në Gjermani brenda kornizës së projektit **28210E001**.

Ky raport është përgatitur sipas njohurive tona më të mira. Megjithatë, ne nuk mund të ofrojmë asnjë garanci për saktësinë ose plotësinë e informacioneve dhe të dhënave të ofruara.

Përmbajtja

A Kosovë: Shifra, të dhëna dhe fakte	3
Harta	
Statistikat e vendit	
Statistikat Bujqësore	
Klima dhe Toka	
Flora dhe Fauna	
Regjimi tregtar	
B Sektori Organik në Kosovë	7
Legjislacioni Kombëtar për prodhimin organik	
Shoqatat dhe Organizatat	
Certifikimi Organik	
Edukimi dhe Trajnimet	
Kërkimet shkencore	
Donatorët, programet dy dhe shumëpalëshe	
C Prodhimi Organik dhe Përpunimi	11
Produkte pyjore jodrunore	
Prodhues / Fermerë	
Grumbullues / Përpunues	
Përpunues / Eksportues	
Tregu Organik	
Analiza SWOT	
D Konkluzionet	22
E Referencat	23

Kosovë: Shifra, të dhëna dhe fakte

Harta




Figura 1: Harta e Kosovës

Kosova është një vend pa dalje në det, e vendosur në juglindje të Evropës në zemër të Gadishullit Ballkanik. Kufizohet me Maqedoninë e Veriut në Jug, Shqipërinë në Perëndim, Malin e Zi në Veri-Perëndim dhe Serbinë në Veri dhe Lindje. Kufijtë

karakterizohen me male të mprehta dhe lugina të ngushta.

Malet e Sharrit shtrihen përgjatë kufirit me Maqedoninë e Veriut, ndërsa malet e Kopaonikut përgjatë kufirit verilindor me Serbinë.

Statistikat e vendit¹

10,905.25 km²

Sipërfaqe

1.79 Milion

Popullsia

164.90 banorë / km

Dendësia e popullsisë

30.2 vjet

Mosha mesatare e popullsisë (2011)

61.7 %

Popullsia që jeton në zonat rurale

4.98 banorë

Madhësia mesatare e familjes

Euro €

Monedha

6,772 Milion Euro

Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) me çmime aktuale

3,772 €

PBB për kokë banori

25.9 %

Shkalla e papunësisë

Statistikat bujqësore²

498.5 Milion Euro

Bujqësia, gjuetia, pylltaria dhe peshkataria – Vlera e Shtuar Bruto me çmime aktuale

7.4 %

Kontributi i bujqësisë në PBB

78.1 Milion Euro

Eksportet bujqësore

16.4 %

Pjesëmarrja e eksporteve bujqësore në totalin e eksporteve

765.4 Milion Euro

Importet bujqësore

23.2 %

Pjesëmarrja e importeve bujqësore në totalin e importeve

-687.3 Milion Euro

Bilanci tregtar i produkteve bujqësore

¹ Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2021.

² Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural 2021.

Klima dhe Toka

Kosova shtrihet ndërmjet $N43^{\circ}16'$; $S41^{\circ}53'$; $E21^{\circ}16'$; $W19^{\circ}59'$ dhe është e ndarë në dy fusha kryesore, atë të Fushës së Dukagjinit në perëndim dhe të Kosovës në lindje. Pika më e ulët e lartësisë mbidetare është 265 m mbi nivelin e detit dhe ndodhet te “Drini i Bardhë” në kufi me Shqipërinë dhe ngritet në 2,656 m mbi nivelin e detit e cila ndodhet në pjesën jugore të Kosovës të quajtur Gjeravicë. Në total, rreth 80 % e gjithë sipërfaqes shtrihet nën 1000 m lartësi mbidetare. Rrafshi i Kosovës përqafon Luginën e Ibrit e cila ndikohet nga masat ajrore kontinentale. Prandaj, dimrat në rrafshin e Kosovës janë shumë më të ftohtë në krahasim me rrafshin e Dukagjinit, i cili ndikohet nga masat ajrore që kalojnë detin Adriatik dhe temperaturat gjatë stinës të dimrit variojnë midis -10°C deri në -26°C . Vera është zakonisht shumë e nxehtë dhe temperaturat variojnë nga 20°C deri në 37°C . Klima në rrafshin e Kosovës është mesatarisht e thatë me reshje mesatare vjetore prej 600 mm në vit.

Në Fushën e Dukagjinit, dimrat janë më të butë dhe temperaturat mujore mesatare variojnë nga 0.5°C deri në 22.8°C . Reshjet mesatare vjetore në rrafshin e Dukagjinit janë rreth 700 mm në vit (Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2021).

Sipas një harte digjitale për llojet e tokës (shkallë 1:50000) prodhuar nga Katedra e Shkencës së Tokës së Universitetit të Prishtinës „Hasan Prishtina“ dhe duke iu referuar klasifikimit WRB-tokë 64 (IUSS Working Group WRB 2006), më shumë se 80 % e sipërfaqes së përdorur bujqësore janë i llojit kambisol, vertisol, fluvisol dhe regosol (Elezi, Halimi & Zogaj, 2004a). Është vlerësuar se 15 % e tokave të Kosovës është e cilësisë së lartë, 29 % është mesatare dhe kryesisht e shpërndarë në rrafshin e Kosovës dhe 56 % është i cilësisë së dobët dhe më së shumti gjendet në zonat kodrinore malore (MBPZHR, 2013).

Flora dhe Fauna

Pjesa më e madhe e diversitetit të bimëve dhe kafshëve gjendet në vendet më të larta malore në rajonet jugore dhe perëndimore të Kosovës. Duke marrë parasysh zonën relativisht të vogël, Kosova konsiderohet të jetë e pasur me specie bimore dhe drurore. Sipas Raportit të Vlerësimit për Biodiversitetin, 13 specie bimore rriten vetëm në Kosovë dhe rreth 200 specie janë identifikuar që rriten vetëm në Ballkan. Kushtet e favorshme në zonat malore ofrojnë habitate të përshtatshme për një

numër të madh të llojeve të gjitarëve p.sh. arinjtë e murrmë, rrëqebulli, macet e egra, ujçit, dhelprat, dhia e egër dhe dreri.

Ndërsa, ekosistemet në lumenj janë rrezikuar vazhdimisht për shkak të nxjerrjes së pakontrolluar të rërës dhe zhavorrit në shtretërit e lumenjve, duke përfshirë ndotjen që vjen nga burimet e brendshme dhe industriale (Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar, 2003).

Regjimi tregtar

Regjimi i përgjithshëm tregtar i Kosovës është liberal dhe i orientuar drejt eksportit. Kosova aplikon TVSH 0 % për produktet finale të eksportuara dhe jo TVSH për inputet e importuara. Strategjia e politikës tregtare të Kosovës është të mbështesë konkurrencën e ekonomisë së Kosovës; megjithatë rritja e bilancit negativ tregtar në dekadën e fundit vështirë se do të mbahet për një periudhë të gjatë kohore. Në vitin 2007, Kosova u bë anëtare e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA). Qëllimi i CEFTA-s është heqja e barrierave për reciprocitetin tregtar në mes shteteve anëtare, gjë që mund të supozohej për të krijuar kushte inkurajuese për zhvillimin dhe diversifikimin e tregtisë,

forcimit të bashkëpunimit ekonomik dhe marrëdhëniet për përfitim reciprok, duke kontribuar në procesin e integritit në BE, duke zhvilluar marrëdhënie tregtare me shtetet anëtare të BE-së si dhe integrimi në sistemin tregtar shumëpalësh (GAP, 2011).

Pavarësisht marrëveshjes, kompanitë kosovare ende nuk mund të eksportojnë në Serbi dhe Bosnje pasi Kosova nuk njihet si vend i pavarur nga këto dy vende anëtarë të marrëveshjes CEFTA. Përcaktuar nga regjimi Preferenca Tregtare Autonome e BE-së (PTA) Kosova gëzon qasje jo reciproke, pa doganë në tregun e BE-së. Megjithatë, për disa ushqime si vera dhe mishi, kufizime të shumta mbeten në fuqi (UNMIK, 2004).

Sektori Organik në Kosovë

Kosova ka kushte të përshtatshme klimatike dhe tokësore për prodhime organike. Grumbullimi i PPJD-ve dhe BMA-ve dominon sektorin organik, derisa prodhimi organik i kulturave tjera është në fazën fillestare. Shumica e sasisë së grumbulluar e PPJD-ve dhe BMA-ve eksportohen si lëndë e parë. Përpunimi është ende shumë i kufizuar dhe tregu ka nevojë të zhvillohet tutje duke i shtuar vlerën këtyre produkteve.

Legjislacioni Kombëtar për Prodhimin Organik

Në tetor të vitit 2012, Kuvendi i Republikës së Kosovës bazuar në nenin 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, miratoi Ligjin Nr. 04/L- 085 për Bujqësinë Organike (Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2012). Qëllimi i këtij ligji është të ofrojë mbështetje për prodhim organik, duke ruajtur funksionimin efektiv të tregut organik, duke siguruar konkurrencë të ndershme, të krijojë besimin e konsumatorit dhe duke mbrojtur interesat e konsumatorit. (Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2012). Ky ligj parasheh nene për dispozitat e përgjithshme, objektivat dhe parimet e prodhimit organik, rregullat e prodhimit të tretë, çështjet e etiketimit, sistemin e kontrollit dhe autoritetin përgjegjës të kontrollit, rregullat e importit, dispozitat ndëshkuese – sanksionet për kundërvajtje që nuk respektojnë këtë ligj dhe i cili përdor produkte dhe substanca të paautorizuara në bujqësinë organike, sigurimi i të dhënave dhe informacionit statistikor në lidhje me Autoritetin e Kontrollit, Organet e Kontrollit dhe operatorët, duke përfshirë Programin Kombëtar për Bujqësinë Organike. Me qëllim të zbatimit efektiv të Ligjit për Bujqësinë Organike, në vitin 2019 MBPZHR ka

miratuar tetë Udhëzime Administrative që mbulojnë çështjet që kanë të bëjnë me përgjegjësitë dhe përbërjen e komisionit për bujqësinë organike, sistemin e kontrollit duke përfshirë autoritetin e kontrollit, organet dhe rregullat për zbatim në prodhimin organik (bimë, blegtori, ushqim për kafshët, akuakultura, përpunim), kriteret, standardet dhe kushtet për importin e produkteve organike, logoja dhe etiketimi specifik. Plani i Veprimit për Bujqësi Organike ishte një politikë kombëtare me kornize kohore 2018–2021 e cila synonte të rriste prodhimin, konsumin dhe pjesëmarrjen më të madhe të produkteve organike në tregun kosovar. MBPZHR, e mbështetur nga palët e tjera të interesit, ka hartuar Planin Organik për Veprim Kombëtar (POVK) për periudhën kohore 2022–24. POVK i ardhshëm parashikon kontributin e Kosovës në bujqësinë organike në Marrëveshjen e Gjellbër Evropiane drejt vitit 2030.

Shoqatat dhe Organizatat

ORGANIKA është e vetmja shoqatë që mbështet anëtarët e saj të certifikohen me standarde organike. Është themeluar në vitin 2013 dhe aktualisht ka 32 anëtarë dhe 28 kompani të certifikuara organike.

Kompanitë e certifikuara organike kryesisht merren me grumbullimin e produkteve pyjore jodrunore (PPJD) dhe grumbullimi/kultivimi i bimëve mjekësore dhe aromatike (BMA). Synimi i shoqatës ORGANIKA është “Zhvillimi i sektorit të PPJD-së dhe BMA-së përmes grumbullimit të qëndrueshëm të PPJD-ve dhe kultivimit të BMA-ve, si dhe rritjes së kapaciteteve prodhuese dhe përpunuese dhe kapaciteteve eksportuese”³. Në vitet e fundit shoqata është mbështetur nga disa donatorë dhe projekte zhvillimore. Programi AGRO i USAID, mbështeti shoqatën për t'u bërë një entitet i vetë-qëndrueshëm. Për më tepër, ndihma e USAID-it ka mbështetur ngritjen e zyrës ORGANIKA duke përfshirë kompensimin e pjesshëm të stafit si dhe mundësimin e pjesëmarrjes në panairë të ndryshme ndërkombëtare. Qëllimi i projektit të USAID-it ishte “të mbështesë programin e zhvillimit bujqësor dhe mundësitë në zonat rurale, veçanërisht zinxhirin e vlerës së frutave të buta (përfshirë: luleshtrydhet, mjedrën dhe boronicën) dhe zinxhirin e vlerës së bimëve aromatike dhe mjekësore (përfshirë PPJD-të dhe ato të rritura në kushte organike dhe duke pasur një treg të qëndrueshëm dhe eksport)” (MBPZHR, 2020). **Projekti GIZ Krijimi i Punësimit përmes Promovimit të Eksportit** mbështeti aktivitetet e ORGANIKA-s në lidhje me trajnimet e palëve të interesuara mbi kultivimin e BMA-ve organike dhe shtypjen e materialeve trajnuese për kultivimin e BMA-ve në Kosovë. Projekti **Promovimi i Punësimit në Sektorin Privat**, i financuar nga **Swiss Contact** në Kosovë, ka mbështetur certifikimin organik të anëtarëve të saj. Gjatë periudhës 2017 dhe 2018, falë kësaj mbështetjeje janë certifikuar organikisht 42 anëtarë të ORGANIKA-së.

Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës (IADK) përmes projekteve të saj ka mbështetur studentët, të sapodiplomuarit dhe fermerët me trajnime, praktika dhe grante për të kontribuar më tej në zhvillimin e sektorit të BMA-ve në Kosovë. Studentët dhe të sapodiplomuarit u trajnuan dhe edukimi dhe shkathtësitë e tyre synuan përputhjen me kërkesat e kompanive përkatëse në sektorin e BMA-ve. Ndërsa, fermerët janë trajnuar dhe këshilluar për kultivimin e BMA-ve duke i mbështetur gjithashtu me grante në mallra si: fidanë, sistem ujitjeje, tharëse natyrale të shoqëruara me pajisje të tjera.

Në vitin 2009, pronarët e pyjeve private të **Kosovës themeluan Shoqatën Kombëtare të Pronarëve të Pyjeve Private (SHKPPP)** me mandatin për të përfaqësuar interesat e pronarëve të pyjeve private lidhur me çështjet pronësore, reformat pyjore dhe përfshirja e pyjeve private në zhvillimin rural, politikat dhe strategjitë pyjore, ofrimin e informacioneve për zhvillimin e sektorit, rritjen dhe ndërgjegjësimin për

mbrojtjen dhe ruajtjen e burimeve natyrore dhe ngritjen e kapaciteteve përmes trajnimeve dhe transferit të njohurive⁴. SHKPPP përbëhet nga 22 Shoqata të Pronarëve të Pyjeve Private (SHPPP) me rreth 4,700 anëtarë. Megjithatë, nuk ka asnjë provë se është bërë përparim i caktuar në lidhje me aktivitetet që mbështesin PPJD-të. Duhet theksuar se brenda SHPPP-ve janë krijuar , 8 Seksione të Grave (SG) nga të cilat 7 grupe prodhuesish janë të përfshirë kryesisht në manaferra dhe BMA. Grupet e grave prodhuese po bëhen promovuese të rëndësishme të sektorit duke kontribuar në të gjithë zinxhirin e vlerës së PPJD-ve dhe BMA-ve.

Certifikimi organik

Në mungesë të organit vendor të kontrollit, certifikimet e produkteve organike në Kosovë bëhen nga katër organe certifikuese ndërkombëtare (MBPZHR, 2020):

- **Albinspekt**,
- **Q-Check P.C.**,
- **Organskakontrola.ba** dhe
- **Bio-inspecta.ch**

Albinspekt është i vetmi organ certifikues / inspektues shqiptar i akredituar dhe i listuar nga Komisioni Evropian për të ofruar shërbimin e certifikimit sipas Rregullores Organike Evropiane. Albinspekt gjithashtu njihet edhe nga Komisioni Shtetëror i Produkteve Organike në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për ofrimin e certifikimit sipas ligjit 106 / 2016.

Informacion

ORGANIKA

www.organika-ks.org/en/home/

Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës (IADK)

www.iadk.org

3 ORGANIKA, 2022.

4 Shoqata Kombëtare e Pronarëve të Pyjeve Private (SHKPPP), <https://www.landcoalition.org/en/explore/our-network/association-of-private-forest-owners-of-kosovo-pyjet-e-kosoves/>

Q-Check është gjithashtu një Organ i pavarur certifikues dhe inspektues i akredituar me bazë në Greqi dhe ofron inspektime të akredituara të Bujqësisë Organike sipas Rregulloreve të Këshillit dhe Komisionit të KE-së (KE)834/2007 dhe (KE)889/200. Standardet e certifikimit të BE-së zbatohen gjithashtu për dy organet e tjera inspektuese/ certifikuese si Bio-inspecta.ch dhe Organskakontrola.ba. MBPZHR është autoritet përgjegjës për të siguruar sistemin e kontrollit, autoritetin e kontrollit dhe organet e kontrollit për certifikimin e bujqësisë organike, produkteve dhe ushqime të mbështetura nga partnerët ndërkombëtarë p.sh. USAID, GIZ.

Edukimi dhe Trajnimet

Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë i Universitetit të Prishtinës është institucioni lider në vend në mësimdhënie, mësimnxënie dhe hulumtim në fushën e bujqësisë. Mësimdhënia në bujqësi organike zbatohet përmes lëndëve të ndryshme të përfshira në kurrikulat e programeve të studimit, p.sh. BSc në Prodhimtari Bimore, MSc në Mbrojtjen e Bimëve dhe MSc në Pemëtarë dhe Vreshtari. Nuk ka program studimi i ofruar nga ndonjë universitet publik apo privat në vend, i cili është hartuar posaçërisht për bujqësi organike. Trajnime dhe shërbime këshillimore në bujqësinë organike ofrohen kryesisht nga MBPZHR, ORGNANIKA, IADK dhe CNVP.

Kërkimi

Kërkimet në lidhje me prodhimet organike janë shumë të kufizuara. Një hulumtim i fundit është kryer mbi sjelljen e konsumatorit ndaj produkteve ushqimore organike në Kosovë. Studimi i kryer nga Miftari et al., (2022) zbuloi se shqetësimet shëndetësore, certifikimi dhe shqetësimet mjedisore ndikojnë ndjeshëm në qëndrimet e konsumatorëve ndaj produkteve ushqimore organike. Përderisa në vendet e zhvilluara, shqetësimi mjedisor është një shtytës kryesor i kërkesës për produkte organike, në rastin e Kosovës që ende përballet me probleme serioze të sigurisë ushqimore, shqetësimi shëndetësor është një faktor kryesor që lidhet me preferencën për ushqimin organik. Duke përdorur instrumentin “Food Related Lifestyle” (FRL), një studim i kryer nga Imami et al., (2021) tregoi se grupet e konsumatorëve më të rinj dhe më të arsimuar kujdesen më shumë për përmbajtjen dhe origjinën e ushqimit dhe kanë shqetësime më të larta mjedisore si dhe kanë një preferencë më të madhe për ushqimet organike. Rritja e

ndërgjegjësimit në lidhje me sigurinë dhe cilësinë e ushqimit të kombinuara me shqetësimet mjedisore pritet të zhvendosin preferencat e konsumatorit ndaj ushqimeve organike, të cilat perceptohen si më të shëndetshme dhe më të sigurta. Këtë vit një shoqatë e



Figura 2: Fusha e kultivimit të specit organik

quajtur PePeKo ka filluar të zbatojë një projekt hulumtues për kultivimin organik të specit (varieteti Kurtovska Kapija) e cila përdoret posaçërisht për përgatitjen e Ajvarit. Projekti po zhvillohet në komunën e Suharekës dhe Pejës, e shtrirë në një sipërfaqe prej 1 ha.

Donatorët, programet dy dhe shumëpalëshe

Në tre vitet e fundit MBPZHR-Agjencia e Pagesave ka pasur një marrëveshje të përbashkët me Agjencinë e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), të cilit i është dhënë e drejta për të menaxhuar fondin e **projektit për Rritjen e Bujqësisë dhe Mundësive Rurale**. Buxheti total i projektit ishte 3.6 milion USD, me synim rritjen e zonave të kultivuara, përmirësimin e infrastrukturës, ofrimin e asistencës teknike dhe rritjen e prodhimit organik. Rreth 2.5 milionë USD u dhanë në mbështetje të mjedrës, luleshtrydhes dhe prodhuesit e boronicës në formë granti për vendosjen e bashkëpunimit në mes fermerëve, përpunuesve dhe eksportuesve. Shuma e mbështetjes ndryshonte nga US\$ 50,000 deri në 150,000, me pjesëmarrje në mbështetje prej 50%. Shuma e mbështetjes për BMA-të ishte 500,000 USD me pjesëmarrje në mbështetje prej 70 %.

SWISS Contact përmes projektit **Promovimi i Punësimit në Sektorin Privat (PPSE)** ka mbështetur kompanitë e përfshira në PPJD p.sh. **Fungi LCC** dhe **99 Lule**. Përveç kësaj, PPSE përmes **programit për lehtësimin e certifikimit** ka mbështetur procesin e certifikimit të 30 qendrave grumbulluese. Mbështetja ishte dhënë për kostot e certifikimit në bazë të shpeshtësisë së certifikimit, nëse NVM-ja është certifikuar për herë të parë bashkëfinancimi ishte 50 %, herën e dytë 25 % dhe hera e tretë 15 %.

Agjencia Suedeze e Zhvillimit Ndërkombëtar (SIDA) përmes projektit **Fuqizimi dhe decentralizimi i qëndrueshmërisë së pyjeve private në Kosovë** ka ofruar asistencë teknike dhe kurse trajnuese për përfituesit. Projekti u fokusua në: i) menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve private; ii) decentralizimi i menaxhimit të qëndrueshëm i pyjeve; dhe iii) prodhimi i biomasës së drurit për energjinë e ripërtitshme dhe PPJD-të. Për më tepër, projekti kishte pako mbështetëse për fidanët dhe pajisjet e nevojshme për mbledhjen, kultivimin dhe përpunimin e PPJD-ve. Një tjetër projekt i quajtur **COSiRA Konkurrueshmëria e Sektorit Privat në Zonat Rurale financuar nga GIZ**, mbështeti kompanitë e përfshira në PPJD në lidhje me sfidat me të cilat përballen në menaxhimin e burimeve natyrore si monitorimi i mbledhjes së PPJD-ve, në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare që lidhen me mbrojtjen e mjedisit dhe standardet e tregtisë së drejtë, integrimin në zinxhirët e vlerës ndërkombëtare të PPJD-ve dhe BMA-ve, dhe tërheqjen e investimeve në përmirësimin e zinxhirit të vlerës së PPJD-ve dhe BMA-ve.

Në vitin 2020, IADK ka mbështetur 54 fermerë me pajisje dhe makineri të nevojshme për kultivimin e BMA-ve, sipërfaqet totale të mbështetura ishin 13.5 ha. Kultivuesit e BMA-ve janë mbështetur nga IADK edhe në vitet e kaluara, kryesisht në formën e fidanëve, serrave për tharje, serrave për kultivim, serra termale, moto-kultivator dhe prerës frutash.

Informacion

Promovimi i punësimit në sektorin privat (PPSE)

www.swisscontact.org

Fungo LLC

www.fungo-shpk.com

99 Lule

www.99lule.com

Prodhimi dhe përpunimi organik

Shumica e produkteve organike të certifikuara në Kosovë janë produkte pyjore jo drunore. Eksportimi është kryesisht si mallra gjysmë të përpunuara dhe si lëndë e parë. Vetëm 9% eksportohet si produkt final i përpunuar dhe i paketuar gati për konsum. Një mundësi e shkëlqyer për t'i shtuar vlerën në vend, për të kontribuar në punësim dhe jetë, me kusht që të ketë mbështetje në investimet e nevojshme.

Produkte pyjore jodrunore

Sipërfaqja e përgjithshme pyjore e Kosovës është 481,000 ha, nga të cilat 278,880 ha i takojnë tokës pyjore publike dhe 180,920 ha janë tokë pyjore private (MBPZHR, 2020, f. 95). Produktet pyjore jodrunore (PPJD) dhe bimët mjekësore aromatike (BMA) janë produkte të rëndësishme që rriten si të egra ashtu edhe të kultivuara. Sipërfaqja territoriale është e vogël, por kushtet klimatike dhe thellësia e shtresave aktive të tokës e bëjnë vendin të pasur për nga cilësia dhe sasia.

Zona e grumbullimit të PPJD-ve dhe BMA-ve përbëhet nga tetë zona, ku bëjnë pjesë dy nga zonat e grumbullimit **Parku Kombëtar Sharri** dhe **Bjeshkët e Nemuna** të cilat menaxhohen nga Drejtoritë e Parkut Kombëtar dhe gjashtë zona të tjera (Mitrovicë, Gjiilan, Prizren, Prishtinë, Pejë, Ferizaj), të menaxhuara nga Agjencia e pyjeve të Kosovës (MBPZHR, 2009).

Më shumë se 300 lloje të PPJD-ve dhe BMA-ve janë mbledhur dhe një numër i konsiderueshëm i llojeve janë kultivuar (Organika, 2020). Të paktën 67 lloje kanë

vlerë tregtare dhe kontribuojnë në gjenerimin e të ardhurave dhe mirëqenien ekonomike të familjeve që jetojnë në zonat rurale.

Shpërndarja e grumbullimit në shtate zona
(2009 | ha)




Figura 3

Prodhimi dhe përpunimi organik

Achillea Millefolium – Bar pezmi	Aconitum napellus – Spineri	Alchemilla vulgaris – Viraku	Allium ursinum – Hudhra e egër
Althaea officinalis – Mullaga e bardhë	Arctium lappa – Rrodhja	Arctostaphylos uvaursi – Rrushi arushes	Artemisia absinthium – Pelin
Artemisia-annua – Artemisia	Artemisia vulgaris – Artemisa	Arum maculatum – Kelkeza	Bellis perennis – Luledele
Betulapendula – Mështekne e argjendtë	Boletus edulis – Kërpudha Boletus	Cantharellus cibarius – Kërpudhë kantarel	Capsella bursa-pastoris – Shtraper
Carlina acaulis – Ushonjza	Castanea sativa – Gështenja	Centaurea cyanus – Kokoçeli	Centaureum umbellatum – Kine fushe
Cichorium intybus – Cikorja	Crataegus monogyna – Murrizi	Dryopteris filix-mas – Fieri	Equisetum arvense – Këputja
Fragaria vesca – Dredhza e Malit	Hedera helix – Urthi	Hypericum perforatum – Lule Basami	Iris germanica – Shpatorja Gjermane
Juniperus communis – Dellinjë	Malus sylvestris – Molla e eger	Malva sylvestris – Mullaga	Matricaria chamomilla – Kamomili
Melilotus officinalis – Makthi	Melissa officinalis – Bar Blete	Mentha piperita – Nenexhiku	Morchella conica – Kërpudha Morchella
Ononis spinosa – Kalmuthi	Origanum vulgare – Rigon	Papaver somniferum – Lulkuqja	Plantago lanceolata – Dejçe
Plantago major – Gjethedelli	Primula veris – Aguliçe	Prunus spinosa – Kulumria	Pyrus sp – Dardha egër
Rosa sp. – Kaçja	Rubus fruticosus – Manaferra	Rubus idaeus – Mjedra	Salix-alba – Shelgu
Salvia officinalis – Sherebela	Sambucus ebulus – Shtogu	Sambucus nigra – Shtogu	Satureja-Montana – Trumza
Sideritis scardiac – Çaj Mali	Sorbus aucuparia – Vodha	Taraxacum officinale – Luleshurdhe	Teucrium montanum – Arrësi
Thymus sp – Timus	Tili cordata – Blini	Trifolium pratense – Gjendra	Tussilago farfara – Thundër Mushka
Urtica dioica – Hithra diotike	Vaccinium myrtillus – Boronica	Valeriana officinalis – Valeriana	Verbascum-Thapsus – Netull
Verbena officinalis – Verbena	Viola odorata – Manushaqja	Viola tricolor – Manushaqja e egër	–

Figura 4: Lista e llojeve të PPJD-ve dhe BMA-ve



Figura 5: Kultivimi i Kalendulës nga fermerët



Figura 6: Kultivimi i lules Cian

Nga perspektiva ekonomike dhe potenciali eksportues, PPJD-të dhe BMA-të kryesore në Kosovë janë *Vaccinium myrtillus* (Boronica), *Juniperus communis* (Dëllinjë), *Primula veris* (Aguliçe), *Sambucus nigra* (Shtog), *Mallus sylvestris* (Mollë e egër), *Crataegus monagina* (Mriz), *Castanea sativa* (Gështenja), *Achillea millefolium* (Barpezmi), *Urtica dioica* (Hithra), *Thymus sp* (Listra.), *Rosa canina* (Trëndafili i Egër), *Betulla pendula*, *Origanum vulgare*, *Robinia pseudocacia*.⁵ Në zhvillimin e këtij nënsektori janë të përfshira shumë palë të interesit duke përfshirë mbledhësit e bimëve të egra dhe të kultivuara, grumbullues/përpunues, përpunues/eksportues, shoqata, MBPZHR, Agjencia e pyjeve të Kosovës, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit, Komunat, sistemi arsimor lidhur me pyjet, donatorët dhe institucionet financiare.

Prodhuesit / Fermerët

Mbledhësit dhe prodhuesit e PPJD-ve dhe BMA-ve janë zakonisht njerëz që jetojnë në zona malore ose rurale dhe kanë grumbullimin dhe kultivimin e PPJD-ve dhe BMA-ve si aktivitetit kryesor. Mbledhësit janë ata të cilët bëjnë përzgjedhjen primare të thellë të produkteve të mbledhura, pastaj ua shesin grumbulluesve/përpunuesve ose diku direkt në treg. Vendi vlerësohet të ketë rreth 20,000 mbledhës, kryesisht gra dhe fëmijë dhe shpesh përfshin familjen në tërësi, të ardhurat e të cilëve variojnë midis 12-15 euro në ditë. Fermerët që kultivojnë PPJD dhe BMA janë ata që kryesisht u përgjigjen nevojave të grumbulluesve në lidhje me llojin, sasinë dhe kohën.

Sipërfaqja totale e kultivuar me BMA (2017–2019 | ha)




Figura 7



Figura 8: Një fermere znj. Zarije Malsiu duke mbledhur lule Kalendula

Grumbullesit / Përpunuesit

Roli kryesor i grumbulluesve dhe përpunuesve të PPJD-ve dhe BMA-ve të egra dhe të kultivuara është për të lidhur mbledhësit dhe eksportuesit në zinxhirin e vlerës. Ata janë të informuar mirë për kërkesën dhe ofertën e këtyre produkteve dhe shërbejnë si rregullatorë ndërmjet mbledhësve dhe eksportuesve duke ofruar informacion mbi çmimet, vëllimin, cilësinë, kërkesat e përpunimit dhe eksportit. Në shumicën e rasteve ata nuk kanë një linjë përpunimi; prandaj, ata kanë prirje t'ua shesin produktet e tyre përpunuesve/eksportuesve. Është vlerësuar se numri i përgjithshëm i grumbulluesve/përpunuesve që operojnë në sektorin e PPJD-ve dhe BMA-ve është afërsisht 100.⁶

5 Raporti i vlerësimit për produktet pyjore jodrunore dhe medicinale dhe sektori i bimëve aromatike 2019. Shoqata Organika, shih <https://organika-ks.org/en/publications/>

6 Të dhëna nga GIZ / Projekti Cosira: “Përcaktimi i zonave të grumbullimit dhe kuotat e produkteve pyjore jodrusore në Kosovë”.

Përpunuesit / Eksportuesit

Rreth 41 përpunues/eksportues operojnë në vend, të cilët kanë linja përpunimi dhe paketimi që përmbushin kërkesat e tregut ndërkombëtar për sa i përket cilësisë dhe standardeve të sigurisë (shih Shoqatën ORGANIKA). Nga 41 përpunues/eksportues të përfshirë në këtë sektor, 35 klasifikohen si mikrondërmarrje me më pak se 10 punonjës, 5 i përkasin ndërmarrjeve të vogla me 10–49 të punësuar dhe 1 është ndërmarrje e shkallës së mesme me 50–249 punonjës (shih po aty). Që nga viti 2013, përpunuesit / eksportuesit e PPJD-ve dhe BMA-ve kanë themeluar një Shoqatë të quajtur "ORGANIKA", qëllimi i së cilës është të forcojë bashkëpunimin ndërmjet aktorëve të zinxhirit të vlerës për PPJD-të dhe BMA-të dhe të kryejnë aktivitete lobimi në lidhje me promovimin e sektorit në tregun ndërkombëtar.

Shpërndarja e totalit të prodhimit/përpunimit sipas PPJD-ve dhe BMA-ve dhe madhësia e ndërmarrjes (2020)

Madhësia e ndërmarrjes	Nr. i ndërmarrjeve	Prodhimi/përpunimi total në ton	Përpunimi i PPJD-ve në ton	Prodhimi/përpunimi i BMA-ve
Mesatare 50 – 249 punonjës	një	1316.35	1182.05	134.3
E vogël 10 – 49 punonjës	5	3342.65	3240.4	102.25
Mikro me më pak se 10 punonjës	35	3596.82	3053.8	543.02
Total	41	8255.82	7476.25	779.57

Figura 9

Agroproduct LCC është e vetmja ndërmarrje e mesme që prinë në eksportin e PPJD-ve dhe BMA-ve. Dy produktet kryesore të përpunuara dhe të eksportuara të kësaj ndërmarrje ishin Dëllinja (*Juniperus Communis*) dhe molla e egër (*Mallus Sylvestris*). Ndërmarrja e mbështetur nga grantet dhe kontributi i donatorëve ka investuar në një depo, serrë për kultivimin e fidanëve, zonë për tharje, dhoma për ftohje, ambiente të reja për linjat e përpunimit dhe mekanizimi për kultivimin e tokës. Bashkëpunimi ndërmjet Agroproduktit dhe rreth 60 grumbulluesve/përpunuesve dhe 3000 mbledhësve në të gjithë vendin është zgjidhur me një kontratë 5-vjeçare. Çmimet ndryshojnë sipas çmimeve të tregut ndërkombëtar, pasi kompania po eksporton pothuajse 95% të prodhimit të saj dhe ate kryesisht në Gjermani,

Austri, Zvicër dhe në Republikën Çeke. Certifikimi organik për PPJD-të dhe BMA-të e mbledhura dhe të kultivuara është marrë nga organi zvicerian i certifikimit BioINSPERTA nga viti 2009–2011, dhe që nga viti 2012 nga organi shqiptar i certifikimit organik Albinspekt. Është i vetmi prodhues në shkallë të madhe të produkteve organike në Kosovë.



Figura 10: Promovimi në panairin e BMA-ve nga Agroprodukt

Informacion

Agroproduct LCC

www.agroproduct-shpk.com/en/about-us/



Fungi LCC është një ndërmarrje tjetër e specializuar në prodhimin e kërpudhave në komunën e Kamenicës. Rreth 95% e produkteve të saj eksportohen në Itali, Zvicër, Gjermani, Holandë, Mal të Zi, Maqedoni, Lituanë dhe SHBA. Ndërmarrja mbledh produktet e saj nga 22 qendra grumbullimi, ku janë të përfshirë mijëra mbledhës dhe angazhon rreth 100 punëtorë sezonalë, duke dhënë kështu një kontribut të çmuar në mundësitë e punësimit në rajon. Dy produktet e saj kryesore janë porcini i thatë i shitur kryesisht në supermarketet zvicerane dhe Morchella Esculenta e thatë që shitet në tregjet ndërkombëtare me çmimin premium. Ndërmarrja ka diversifikuar prodhimin e kërpudhave përmes përpunimit dhe shtimit të vlerës së ajvarit të kërpudhave, i cili quhet **Mama MIA**.



Figura 11: Kërpudha të egra të mbledhura nga Fungo LCC, 2022

Hit-Flores SHPK grumbullon, përpunon dhe eksporton fruta të egra dhe të kultivuara, kërpudha dhe BMA. Furnizimi është kryesisht nga zona grumbulluese e Sharrit dhe punëson 20 punëtorë me orar të plotë dhe 50–120 punëtorë sezonalë.



Figura 12: Promovimi në panairin e PPJD-ve dhe BMA-ve nga Hit Flores



Figura 13: Koleksioni i PPJD-ve dhe BMA-ve nga Hit Flores, 2022

Informacion

Fungo LCC

www.fungo-shpk.com/



Hit-Flores SHPK

www.hitflores.de/



Eurofruti është një tjetër kompani që grumbullon, përpunon dhe bën ngrirjen e frutave të egra. Mesatarja vjetore e grumbullimit të frutave të egra variojnë nga 1500 deri në 2000 ton, dhe afërsisht 100 ton kërpudha të egra. Rreth 95% e produkteve eksportohen kryesisht në vendet e BE-së.

Rreth 95 % e PPJD-ve dhe BMA-ve janë tregtuar si lëndë e parë ose gjysmë e përpunuar. Është vetëm një kompani **Peppermint International** që nxjerr vaj esencial nga shumëllojshmëria e BMA-ve të egra.




Figura 14: Kërpudhat e egra të mbledhura nga Eurofruti, 2022



Figura 15: Manaferra të egra të grumbulluara nga Eurofruti, 2022

më të shiturat nga PPJD-të që kryesojnë eksportin e vendit ishin: 1) manaferra e egër (0.51 milion Euro); 2) kërpudha (0.48 milion euro) 3) dëllinjë (0.47 milionë euro); 4) klipi i lopës (0.31 milion Euro) dhe 5) hudhra e egër (0.27 milionë euro). Ndërsa pesë më të shiturat në grupin e BMA-ve që kryesuan eksportet në 2019 ishin: 1) rigoni (61,500 Euro); 2) mente (34,665 Euro); 3) Mallow (25,560 Euro); 4) Borzilok (20,000 Euro); dhe 5) Lule misri (15,750 Euro). Shitjet e eksportit në 2019 u rritën me 28 % krahasuar me një vit më parë, ndërsa eksporti në vitin 2018 krahasuar me vitin 2017 ishte 10 % më i lartë, duke treguar një trend pozitiv brenda periudhës kohore të dhënë. Kur shikon strukturën e shitjeve të eksportit, shumica (51 %) ishin produkte gjysmë të përpunuara të përcjellura nga lëndë e parë (40 %), dhe vetëm një sasi e vogël (9 %) si produkt final. Këto shifra pasqyrojnë nevojat dhe mundësitë për investime më të mëdha në kapacitetet përpunuese të kësaj industrie që lejon shtimin e vlerës së këtyre produkteve në Kosovë.

Furnizimi me ushqime organike në Kosovë është shumë i kufizuar. Ka vetëm pak dyqane që ofrojnë vetëm produkte ushqimore organike. Në Prishtinë që është kryeqyteti i Kosovës ka vetëm dy dyqane që shesin produkte ushqimore organike 'Dyqani Bio' dhe 'Hambarë'. Shumica e produkteve ushqimore organike importohen nga vendet e BE-së, p.sh., Gjermania, Italia dhe Kroacia. Janë pak produkte ushqimore organike të përpunuara me origjinë nga Kosova p.sh. uthull nga mollët e egra, lëngu i boronicës dhe lëngu i aronisë. Sipas intervistave të realizuara me pronarët e dyqaneve organike, konsumatorët kanë preferencë më të madhe për produktet ushqimore organike me prejardhje nga vendet e BE-së, dhe kjo lidhet me besimin më të madh që kanë në certifikatat organike të BE-së. Kërkesa për produkte ushqimore organike konsiderohet të jetë mjaft e ulët dhe kjo mund të lidhet kryesisht për shkak të fuqisë së ulët blerëse të konsumatorëve dhe ndërgjegjësimi ndaj produkteve ushqimore organike.

Tregu dhe trendet

Përafërsisht 95% e totalit të PPJD-ve dhe BMA-ve eksportohen në tregun e BE-së. Në vitin 2019, shuma totale e eksportit për PPJD-të dhe BMA-të ishte 8.15 milionë euro (kryesisht si koleksion i egër i certifikuar organik), ku shumica (83 %) e shitjeve të eksportit ishte nga PPJD-të. Shitjet totale të PPJD-ve dhe BMA-ve në tregun kombëtar u raportuan 2.2 milion euro. Brenda një game relativisht të gjerë të produkteve të shitura, pesë

Informacion

Eurofruti

www.eurofruti.com/





Figura 16: Dyqani organik “Dyqani Bio”, në Prishtinë



Figura 18: Produktet ushqimore organike në Dyqani Bio Prishtinë



Figura 17: Lëngu organik vendas nga boronica në Dyqani Bio, Prishtinë;
Produktet ushqimore organike në Dyqani Bio, Prishtinë



Figura 19: Dyqani Hambarë në Prishtinë

Marzhat bruto dhe të ardhurat neto të disa BMA-ve të kultivuara

	Hithër (EUR / ha)	Rigoni i bardhë (EUR / ha)	Mente (EUR / ha)	Kamomili (EUR / ha)	Pot Marigold EUR / 0.1 ha	Lule misri EUR / 0.1 ha	Mallow e zakonshme EUR / 0.1 ha
Të ardhurat totale	8.925	7.200	8.100	2.000	1.440	1.350	3.675
Kostot totale të inputeve	1.611	1.287	1.455	484	592	592	592
Kostot totale të makinerive	127	73	83	80	14	16	14
Kostot totale të punës	1.034	887	992	167	382	282	1.857
Shpenzimet tjera	724	710	717	782	19	16	18
Kostot totale variabile	3.498	2.958	3.248	1.514	1.008	908	2.482
Marzhi bruto	5.426	4.241	4.851	485	431	441	1.192
Amortizimi	1.101	1.101	1.376	-	-	-	-
Të ardhurat neto	4.325	3.139	3.474	485	431	441	1.192
+ Subvencionet	500	500	500	500	45	45	45

Figura 20

Niveli i arritjes së standardeve kombëtare dhe të BE-së

Tregjet ndërkombëtare dhe vendase po bëhen nxitësit e përmirësimeve të cilësisë dhe standardeve të sigurisë ushqimore. Në këtë drejtim, procesi i certifikimit i hap rrugën cilësisë së produkteve organike dhe eksportit të tyre. Çdo qendër grumbullimi që eksporton kërkohet të jetë e certifikuar si organike nga trupa certifikuese të njohura ndërkombëtarisht si **ALBINSPEKT**, që operon në Kosovë.

Me qëllim të krijimit të një sektori konkurrues të PPJD-ve dhe BMA-ve, është e rëndësishme të njihen dhe të harmonizohen standardet ndërkombëtare në lidhje me menaxhimin e qendrueshëm e PPJD-ve dhe BMA-ve të tilla si Praktikat e Mira të Bujqësisë dhe Grumbullimit (PMBG) dhe standardet **Fair Wild**.

Fair Wild vlen për mbledhjen e bimëve të egra, qëllimi i të cilit është të sigurojë një grumbullim të qëndrueshëm, duke mbështetur jetesën e mbledhësve, përgjegjësinë sociale dhe parimet e tregtisë së drejtë. Grupi punues i GACP-së ka zhvilluar një Udhëzues për Zbatimin Praktik të GACP-së dhe Standardet e Procedurave të Operimit (SPO) që mund të jenë mbështetëse për uniformitetin e performancës (eficienca dhe efikasiteti) dhe prodhimit cilësor, duke reduktuar keqkomunikimin dhe mosrespektimin me rregulloret e sektorit. Me rëndësi të konsiderueshme për zhvillimin e sektorit janë gjithashtu udhëzimet dhe kodet për praktikën e drejtë në tregtinë ushqimore, të zhvilluara nga komisioni i FAO dhe OBSH për Codex Alimentarius.

Kodet e aplikueshme të Codex Alimentarius për BMA-të mund të jenë ato që lidhen me parimet mbi higjienën, udhëzimet për prodhimin, përpunimin, etiketimin e ushqimeve organike dhe tregtisë.

Standardet e zbatuara nga ndërmarrjet

	BioSuisse	HACCP	IFS	IP	ISO 22000	Kosher	NOP	Organik
Numri i ndërmarrjeve	2	2	0	1	5	1	1	28

Figura 21

Me gjithë investimet, shumë prej ndërmarrjeve përpunuese të sektorit nuk janë në përputhje me standardet e kërkuara që lidhen me sigurinë ushqimore dhe mjedisin. Kjo është kryesisht për shkak të politikave për standardet e cilësisë dhe sigurisë së ushqimit që janë në fazën fillestare, zbatimi i dobët i ligjit, kapaciteteve të kufizuara institucionale dhe investimeve private. Prandaj, të gjitha këto probleme paraqesin rreziqet reale dhe të perceptuara të sigurisë për kompanitë dhe konsumatorët. Brenda kornizës së zbatimit të PZHRB-së, mbështetje iu dha investimeve që synojnë përputhjen me standardet të cilat janë shumë të rëndësishme për forcimin e konkurrencës në sektorin e tregjet e brendshme dhe ndërkombëtare. Mbështetje e mëtejshme nevojitet në përmirësim të kapitalit fizik të këtij sektori, duke përshtatur praktikën e prodhimit, duke zhvilluar sisteme të sigurisë ushqimore, duke vazhduar përditësimin me standardet e reja dhe zhvillimin e kapaciteteve njerëzore për zbatimin korrekt të tyre.

Kosova është anëtare e Zonës për Tregti të Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA) dhe qasje pa doganë te Tregu i BE-së i bazuar në Regjimin e Preferencës së Tregtisë Autonome (ATP). Janë dy instrumente kryesore:

- Ligji mbi Inspektoratin Sanitarë Nr. 2003 / 22;
- Rregullorja Nr. 2003/39, që rregullon kontrollin e cilësisë së ushqimit, sigurisë, higjienës dhe kushtet sanitare.

Kosova ka harmonizuar legjislacionin e saj për sigurinë ushqimore dhe fitosanitarinë sipas standardeve të BE-së, megjithatë shumë më shumë përpjekje duhet bërë drejt anëtarësimit të saj në KODEX Alimentarius, Organizata Evropiane për Mbrojtjen e Bimëve (OEMB), Konventa për Biodiversitetin (CBD), Bashkimi për Mbrojtjen e Varieteteve të Reja të Bimëve (BMVRB), Programi i Bashkëpunimit Evropian për Rrjetet e kulturave dhe burimeve gjenetike (ECP / GR), Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Bimëve (IPPC), Organizata Botërore për shëndetin e kafshëve (OIE), Kontributet e Përcaktuara Kombëtare (NDCs), Neutraliteti i Degradimit të Tokës (LDN). Të gjitha produktet ushqimore në Kosovë duhet të prodhohen në harmoni me ligjet vendore, megjithatë anëtarësimi në OBT dhe organizata tjera ndërkombëtare do të inkurajojë aplikimin e masave sanitare dhe fitosanitare bazuar në standardet, udhëzimet dhe rekomandimet ndërkombëtare. Të qenët anëtare do të thotë që vendi mund të luajë një rol aktiv në zhvillimin e standardeve ndërkombëtare që ndihmojnë në mbrojtjen e produkteve që importohen dhe eksportohen.

Mbështetja e kaluar dhe e vazhdueshme nga MBPZHR

Mbështetja për PPJD-të dhe BMA-të është dhënë nën masën sektori i përpunimit të bimëve mjekësore, frutave të pyllit dhe kërpudhave të mbledhura që nga viti 2015.

Buxheti fillestar i parashikuar për këtë masë ishte 300,000 Euro e cila ishte zvogëluar në dy vitet në vijim 2016 dhe 2017. Në vitin 2018 dhe 2019 kjo masë nuk ishte zbatuar më. BMA-të gjatë këtyre dy viteve të fundit u mbështetën në kuadër të masës 'sektori i përpunimit të fermave dhe tregtimit të produkteve bujqësore në shkallë të vogël'. Numri total i përfituesve të miratuar gjatë 2015–2017 ishte 21, të shpërndara në mënyrë të barabartë në çdo vit.

Që nga viti 2018, BMA-të janë subvencionuar si produkte bujqësore organike në bazë të sipërfaqes së kultivuar p.sh. 1 ha me BMA me certifikate organike u mbështet me 500 Euro/ha. Subvencionimi bazë për prodhuesit e pa certifikuar të BMA-ve ishte 0.00 Euro/ha, që është e ndryshme në krahasim me prodhuesit e perimeve ku subvencionimi bazë ishte 300 Euro/ha + 500 Euro/ha nëse është i certifikuar si organik.

Pagesat direkte janë paguar në bazë të sipërfaqes minimale të pranueshme (0.10 ha) të mbjellura me kultura organike dhe për të cilën kanë certifikatën për prodhim organik. Subvencionimi është dhënë për sipërfaqe/hektar, në shumë prej 500 Euro/ha. Buxheti i planifikuar për subvencionimin e prodhimit organik ishte 110,000 euro (MBPZHR, 2020).

Nga intervistat në terren, takimet me fokus grupet dhe statistikën për skemat mbështetëse të këtij sektori, shihet se mbështetja e këtij sektori ishte shumë e vogël në lidhje me kërkesat për investime dhe potencialin për zhvillim dhe kontributin në punësim, ekonominë e vendit dhe bilancin tregtar.

Buxheti i projektuar dhe miratuar në mbështetje të PPJD-ve dhe BMA-ve (2015–2017 | Euro)




Figura 22

Analiza SWOT

Piket e forta

- Disponueshmëria e tokës së pastër që ofron një bazë të mirë për zgjerimin e sipërfaqeve të kultivuara me prodhime organike (BMA).
- Kostoja më e ulët e kultivimit e bën më të lehtë përfshirjen në prodhim, veçanërisht për gratë dhe të rinjtë në zonat rurale të cilët përgjithësisht janë më të dobët ekonomikisht.
- Cilësi e lartë e produkteve (PPJD dhe BMA).
- Lidhje të mira tregu të zhvilluara nga përpunuesit/eksportuesit, grumbulluesit/përpunuesit dhe prodhuesit/mbledhësit.
- Kontribut i rëndësishëm i sektorit në punësimin kombëtar (afërsisht 20,000 mbledhës, 100 grumbullues/përpunues dhe 41 përpunues/eksportues) dhe ekonominë (8.15 milionë euro në 2020).

Dobësitë

- Mekanizimi i kufizuar dhe i vjetëruar, traktorët, dhe makineritë e korjes për shkak të kufizimeve buxhetore.
- Instalim i kufizuar i sistemit të ujitjes.
- Objektet e kufizuara të magazinimit (tharëse dhe ngrirëse), dobësojnë cilësinë e produkteve, mbingarkesën e punës dhe koston më të lartë të prodhimit.
- Informacione dhe njohuri të kufizuara nga ana e mbledhësve për atë se çka përfaqëson një vjelje e qëndrueshme e PPJD-ve dhe BMA-ve.
- Nivel i kufizuar i standardeve sa i përket cilësisë dhe sigurisë së arritur kombëtare në krahasim me ato të BE-së.

Nevojat për të rritur piket e forta në sektor/biznes

- Mbështetja teknike nga MBPZHR për të marrë miratimin e cilësisë së tokës dhe perspektiva e përdorimit të tokës.
- Mbështetja dhe ngritja e kapaciteteve (njohuritë teorike dhe aftësitë praktike) të grave, fermerëve të rinj dhe fermerëve në tranzicion për prodhimin organik në lidhje me vlerësimin e shëndetit të tokës, menaxhimin e barërave të këqija, ujitjen dhe menaxhimin e ujit, menaxhimin e insekteve dhe dëmtuesve, menaxhimin e sëmundjeve, ekonominë dhe marketingun.
- Mbështetje teknike dhe financiare nga MBPZHR në certifikimin e cilësisë së produktit (p.sh. Organik, Praktikat e mira prodhuese. Zhvillimi i tregut të veçantë, çmime premium për produktet e certifikuar me cilësi të lartë.
- Mbështetje në zhvillimin e mëtejshëm të potencialit të tregut për produkte të certifikuar dhe gjurmueshmërinë e produkteve.
- Rreth 90% e PPJD-ve dhe BMA-ve shiten si produkte të papërpunuara dhe gjysmë të përpunuara. Nevojitet më shumë mbështetje për të investuar në përmirësimin e vlerës së shtuar të këtyre produkteve dhe për të ulur dallimet midis krijimit dhe kapjes së vlerës në treg.

Nevojat për të reduktuar dobësitë në sektor/biznes

- Nevojitet mbështetje financiare për investime në makineri bujqësore.
- Mbështetje financiare për ujitje.
- Më shumë investime të mbështetura në infrastrukturën e pas-vjeljes p.sh. ambiente magazinimi për grupin e prodhuesve.
- Më shumë trajnime për vjelësit mbi grumbullimin e PPJD-ve dhe BMA-ve duke ndjekur standardet dhe udhëzimet për vjelje të qëndrueshme.
- Mbështetje teknike dhe financiare nga MBPZHR në cilësinë e produktit dhe certifikim (p.sh. organik, praktikat e mira prodhuese).

Mundësitë

- Disponueshmëria e lëndës së parë e mjaftueshme (PPJD), pasi konsiderohet se vetëm 10% e kapacitetit prodhues është mbledhur.
- Trend pozitiv i kërkesës për PPJD dhe BMA (në nivel vendor dhe ndërkombëtar).
- Qasje e lehtë në treg me një rritje prej 28 % në 2019 krahasuar me 2018 dhe 10 % në 2018 krahasuar me 2017.
- Formimi i grupeve të fermerëve, duke filluar nga organizimi dhe marketingu; shërbimet e përbashkëta të makinerive; p.sh. tharëse ose ngrirëse në pronësi të përbashkët.
- Përpunuesit/eksportuesit e interesuar që të rishikojnë dhe pranojnë mbështetjen nga skemat e MBPZHR për PPJD dhe BMA.
- Niveli i përvijës i krijuar nga prodhuesit kryesorë, grumbulluesit / përpunuesit dhe përpunuesit / eksportuesit mund të lejojnë zgjerimin e zonave me PPJD dhe BMA.
- Zbatimi i ligjit do të kufizojë mbishfrytëzimin e PPJD-ve dhe BMA-ve.
- Përmirësimi i strategjisë së marketingut mund të rrisë ndërgjegjësimin e konsumatorëve vendas për PPJD dhe BMA.

Nevoja për të zbutur kërcënimet

- Çmimet e inputeve të jenë të pajtueshme me tregun botëror.
- Të ristrukturohet shërbimi këshillues në kuadër të MBPZHR; trajnimi dhe pajisja e ekstensionistëve me makina për të arritur fermerët (dhe monitorimi në mënyrë të vazhdueshme për performancën e tyre); Zyrtarëve qeveritarë duhet të ju kufizohet mundësia për të ofruar shërbime me pagesë pas orarit të punës.
- Nxitja e skemave financiare të përballueshme.
- Fuqizimi i kapaciteteve në drejtim të masave monitoruese drejt vjeljes së qëndrueshme të PPJD-ve dhe BMA-ve.

Kërcënimet

- Agroinpute të shtrenjta dhe jo të besueshme; cilësi e diskutueshme e inputeve të shitura për shkak të kapaciteteve të kufizuara të inspektimeve.
- Sistemi këshillues i MBPZHR dhe komunave në gjendje jo të mirë; këshilltarët e “certifikuar” dështuan; gjithashtu dështoi kursi i trajnimit “i tenderuar”.
- Normat e larta të interesit kufizojnë marrjen e kredive për investime të nevojshme.
- Migrimi i brendshëm dhe i jashtëm nga zonat malore mund të zvogëlojë numrin e mbledhësve dhe kështu të shkaktojë mungesë të lëndës së parë për përpunuesit e PPJD-ve dhe BMA-ve.
- Brezi i ri i pa interesuar për bujqësinë, veçanërisht nëse nuk është i njohur me të (përmes shkollave profesionale të avancuara); edhe rritja e migrimit në vendet e BE-së tërheq më shumë të rinj nga zonat rurale.
- Kushtet e motit dhe zjarret në pyje vendosin në rrezik rritjen dhe procesin e vjeljes së PPJD-ve dhe BMA-ve.

Nevoja për të vlerësuar mundësitë

- Ekziston nevoja për përzgjedhjen dhe përdorimin e metodave të përshtatshme biometrike që do të lejojnë kuantifikimin dhe parashikimet më të sakta të burimeve në rajone të ndryshme për PPJD dhe BMA.
- Rritja e investimeve në zinxhirin e vlerës së PPJD-ve dhe BMA-ve.
- Rritja e ndërgjegjësimit për “bashkëpunim”; vizita në grupe të suksesshme.
- Rritja e pragut të mbështetjes ose përfshirja nën-skema të reja që mbështesin investimet e nevojshme në përpunimin e PPJD-ve dhe BMA-ve.
- Më shumë trajnime dhe të një cilësie më të mirë për vjelësit dhe prodhuesit kryesorë për mbledhjen e llojeve të ndryshme duke ndjekur standardet dhe udhëzimet për vjeljen dhe kultivimin e qëndrueshëm të PPJD-ve dhe BMA-ve.
- Koordinimi i kuadrit rregullativ dhe ligjor për PPJD-të dhe BMA-të ndërmjet MBPZHR dhe Ministrisë së Mjedisit.

Konkluzionet

Sektori i PPJD-ve dhe BMA-ve duket të jetë sektori organik më premtues në Kosovë. Megjithatë, rreth 90% e PPJD-ve dhe BMA-ve shiten si produkte të papërpunuara dhe gjysmë të përpunuara. Deri më tani mbështetja për PPJD- të dhe BMA- të është dhënë nën masën për diversifikimin e aktiviteteve dhe të hyrave në zonat rurale. Shuma e mbështetjes së dhënë nën këtë masë nuk përputhet me shumën e investimeve të nevojshme. Prandaj, nevojitet më shumë mbështetje në investime për të përmirësuar vlerën e shtuar të këtyre produkteve dhe për të ulur diferencat midis krijimit dhe kapjes së vlerës në treg. Duke marrë parasysh se shumë nga fermat e Kosovës janë të përmasave të vogla dhe me përdorim të vogël të plehrave artificiale dhe pesticideve si dhe me qasje të kufizuara në makineri bujqësore të avancuar, transformimi në bujqësi organike mund të marrë më pak përpjekje dhe kohë.

Të kesh certifikim organik vendas të besueshëm është vendimtare për të përmirësuar besimin e konsumatorit si real ashtu edhe atë të perceptuar ndaj produkteve ushqimore organike që shiten në treg. Hulumtimi mbi prodhimin organik në Kosovë është shumë i kufizuar, prandaj nevojitet mbështetje për hulumtime të zgjeruara mbi prodhimin organik dhe kuptim më të mirë të sjelljes/perceptimit të konsumatorëve ndaj produkteve ushqimore organike, duke përfshirë edhe perspektivën e politikëbërjes.

Fuqizimi dhe intensifikimi i bashkëpunimit dhe shkëmbimeve ndërmjet institucioneve të përfshira dhe palëve me interes, gjë që mund të nënkuptojë vizita të përshtatura për prodhuesit e Kosovës në rajon dhe vendet e tjera të BE-së, derisa ata gjithashtu mund të shkëmbejnë përvojat dhe mësimet më të mira me kolegët e përfshirë në bujqësi/përpunim organik e cila do të ishte një ndihmë e madhe për ata.

Referencat

Figurat

1	Harta e Kosovës	3
2	Fusha e kultivimit të specit organic, burimi: Shoqata PePeKo, 2022	9
3	Shpërndarja e grumbullimit në shtatë zona, burimi: Strategjia e Kosovës për Zhvillimin e Pyjeve 2010–2020	11
4	Lista e llojeve të PPJD-ve dhe BMA-ve, burimi: Shoqata Organika, 2019	12
5	Kultivimi i Kalendulës nga fermerët, burimi: Shoqata Organika, 2022	12
6	Kultivimi i lules Cian, burimi: Shoqata Organika, 2022	12
7	Sipërfaqja totale e kultivuar me BMA (2017–2019 ha), burimi: Raporti i Gjellbër i Kosovës, MBPZHR	13
8	Një fermere znj. Zarije Malsiu duke mbledhur lule Kalendula, burimi: Ferma Biofruti, 2022	13
9	Shpërndarja e totalit të prodhimit/përpunimit sipas PPJD-ve dhe BMA-ve dhe madhësia e ndërmarrjes (2020), burimi: Shoqata Organika, 2019	14
10	Promovimi në panairin e BMA-ve nga Agroprodukt, burimi: Agroproduct, 2019, www.agroproduct-shpk.com (26.09.2022)	14
11	Kërpudha të egra të mbledhura nga Fungo LCC, 2022, burimi: www.fungo-ff.org (26.09.2022)	15
12	Promovimi në panairin e PPJD-ve dhe BMA-ve nga Hit Flores, burimi: Hit Floers, 2018, www.hitflores.de (26.09.2022)	15
13	Koleksioni i PPJD-ve dhe BMA-ve nga Hit Flores, 2022, burimi: Hit Floers, 2018, www.hitflores.de (26.09.2022)	15
14	Kërpudhat e egra të mbledhura nga Eurofruti, 2022, burimi: www.eurofruti.com/index.php/gallery/ (26.09.2022)	16
15	Manaferra të egra të grumbulluara nga Eurofruti, 2022, burimi: www.eurofruti.com/index.php/gallery/ (26.09.2022)	16
16	Dyqani organik “Dyqani Bio”, në Prishtinë, burimi: Foto nga autori	17
17	Lëngu organik vendas nga boronica në Dyqani Bio, Prishtinë; Produktet ushqimore organike në Dyqani Bio, Prishtinë, burimi: Foto nga autori	17
18	Produktet ushqimore organike në Dyqani Bio Prishtinë, burimi: Foto nga autori	17
19	Dyqani Hambarë në Prishtinë, burimi: https://www.facebook.com/hambarestore/ (24.12.2022)	17
20	Marzhat bruto dhe të ardhurat neto të disa BMA-ve të kultivuara, burimi: Katalogu Ekonomik për BMA- të, 2021 IADK	18
21	Standardet e zbatuara nga ndërmarrjet, burimi: Shoqata Organika, 2019	18
22	Buxheti i projektuar dhe miratuar në mbështetje të PPJD-ve dhe BMA-ve (2015–2017 Euro), burimi: Raporti i Gjellbër i Kosovës 2015–2017, MBPZHR	19

Bibliografia

Assembly of Republic of Kosovo, 2012. Law No. 04 / L-085 ON ORGANIC FARMING. Prishtine: Assembly of Republic of Kosovo; <http://app.seerural.org/wp-content/uploads/2013/08/Kosovo-Law-on-Organic-Farming-October-2012-ENG.pdf>, 2012.

Consumer Perceptions about Organic Food Applying Food Related Lifestyle Approach. Imami, D.; Miftari, I.; Kaliji, A. S.; Canavari, M.; Gjokaj, E. 2021. s.l.: INTERNATIONAL FOOD AND AGRIBUSINESS MANAGEMENT ASSOCIATION (IFAMA), 2021.

Factors Influencing Consumer Attitudes towards Organic Food Products in a Transition Economy — Insights from Kosovo. Miftari, I.; R., Haas; Meixner, O.; Imami, D.; Gjokaj, E. 2022. 14, s.l.: Sustainability, 2022, Vol. 10.

GAP, 2011. Policy brief, Kosovo in CEFTA: In or Out?. Prishtine: GAP, 2011.

Kosovo Agency of Statistics, 2021. Statistical Year Book of Republic of Kosovo 2021. Prishtine: Kosovo Agency of Statistics, 2021.

MAFRD, 2013. Horticultural strategy of Kosovo 2009–2013. Prishtine: MAFRD, 2013.

Kosovo Green Report 2020. Prishtine: MAFRD, 2020.

Ministry of Agriculture Forestry and Rural Development, MAFRD, 2021. Kosovo Agriculture in Numbers. Prishtine: MAFRD, 2021.

United State Agency for International Development, 2003. Kosovo Biodiversity Assessment. Prishtine: USAID, 2003.

UNMIK, Ministry of Trade and Industry and, 2004. Trade Policy for Kosovo. Prishtine: s.n., 2004.